

V E N D I M
Nr. 407, datë 29.8.2002

**PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT ME STREHIM TË INVALIDËVE PARAPLEGJIKË DHE
TETRAPLEGJIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, 17 dhe 21 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidëve paraplegjikë e tetraplegjikë” dhe të neneve 1 e 13 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të planifikojë fonde për të pastrehët me statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, në bazë të kërkesave që organet e qeverisjes vendore i dërgojnë Entit Kombëtar të Banesave, brenda datës 1 gusht të çdo viti.

2. Organet e qeverisjes vendore t’u japin në çdo kohë statusin e të pastrehut invalidëve që përcaktohen të tillë nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë dhe që marrin “Dëshmi zyrtare identifikimi” nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

3. Përparësi në dhënien e statusit të të pastrehut dhe në trajtimin me strehim nga shteti, në mbështetje të nenit 12 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, kanë rastet kur:

a) familja, kryefamiljari i së cilës ka statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, banon në mjedise që nuk janë fond banese;

b) familja, kryefamiljari i së cilës ka statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, zotëron sipërfaqe banimi më pak se normat e strehimit në fuqi;

c) familja, një pjesëtar i së cilës ka statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, banon në sipërfaqe nën normat e strehimit në fuqi dhe është në gjendje të vështirë ekonomike.

4. Shpenzimet e Entit Kombëtar të Banesave përballohen nga Buxheti i Shtetit në rastet kur:

a) individi i pastrehë, me statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, është kryefamiljar;

b) familja, që ka në përbërje një pjesëtar me statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, ka të ardhura për frymë më pak se 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.

5. Qendër banimi për individët që kanë përfitur statusin e të pastrehut nga statusi i invalidit paraplegjik ose tetraplegjik merret qendra ku ata kanë përfitur statusin e të pastrehut.

6. Në qytetet, ku vlera e banesave në treg është më e vogël se kostoja mesatare e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, apartamentet të blihen, për invalidin paraplegjik ose tetraplegjik, në katet e para të banesave tip, sipas kritereve të përcaktuara në vendimin nr.286, datë 2.6.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e blerjes dhe shitjes së apartamenteve nga Enti Kombëtar i Banesave në tregun e lirë të banesave”. Kur, me pëlqimin e familjes, apartamenti blihet në banesa të pajisura me ashensorë, diferenca ndërmjet vlerës së apartamentit me fondin limit të blerjes, sipas vendimit nr.286, datë 2.6.2000 të Këshillit të Ministrave, shlyhet nga qytetari i pastrehë.

7. Në qytetet ku vlera e apartamenteve në treg është më e lartë se kostoja mesatare e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe ky i fundit nuk investon në ndërtime të reja, qytetari me statusin e invalidit paraplegjik a tetraplegjik ose familja e tij përfiton nga tregu i lirë i banesave. Në këtë rast, Enti Kombëtar i Banesave me paraqitjen e kontratës së shitblerjes së apartamentit ndërmjet qytetarit të pastrehë dhe shitësit të apartamentit, shlyen vlerën, e cila është e barabartë me vlerën limit të apartamentit që përfiton familja. Diferenca ndërmjet vlerës së apartamentit të blerë në treg me fondin limit të apartamentit, shlyhet nga vetë familja e pastrehë.

8. Në të gjitha rastet e parashikuara në pikat 5 dhe 6 të këtij vendimi, vlera limit e apartamentit që përfiton qytetari i pastrehë shlyhet pranë Entit Kombëtar të Banesave, sipas kritereve të përcaktuara në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

9. Deri në hartimin e normave të projektimit të godinave të banimit për kategoritë me kërkesa të veçanta, të përdoren katet e para të godinave, që do të ndërtohen ose blihen nga Enti Kombëtar i Banesave, për trajtimin e personave sipas pikave 5 dhe 6 të këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Punës dhe

Çështjeve Sociale, organet e qeverisjes vendore dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano